

Fletë informuese për nisjen e shkollës në vjeshtën e 2020¹

Semafori i koronavirusit përbëhet nga katër nivele paralajmëruese: "I gjelbër – I verdhë – Portokalli – I kuq"². Semafori i koronës tregon me një shikim se çfarë masash duhen marrë dhe çfarë rregullash duhen zbatuar për të kufizuar përhapjen e koronavirusit në mënyrën më të mirë të mundshme.

Në të gjitha fazat e semaforit komunikimi (elektronik) mes mësuesve dhe prindërve/kujdestarëve ligjorë është veçanërisht i rëndësishëm!

Në të gjitha sinjalizimet e semaforit duhen zbatuar rregullat që e përgjithshme të higjienës!

I GJELBËR	I VERDHË Rregullat sipas TË GJELBRIT +	PORTOKALLI Rregullat sipas TË VERDHIT +	I KUQ Rregullat sipas PORTOKALLISË +
Mbajtja e maskës mbrojtëse është me vullnet të lirë	Mbajtja e maskës mbrojtëse nga hyrja në ndërtesën e shkollës deri tek ulja në bankë është e detyrueshme	Mbajtja e maskës mbrojtëse nga hyrja në ndërtesën e shkollës deri tek ulja në bankë është e detyrueshme	Funksionet e shkollës kalojnë në Distance Learning (mësim në distancë)
Ajrim i rregullt i ambienteve	Mbajtja e maskës mbrojtëse është e detyrueshme për të gjithë nxënësit dhe mësuesit jashtë klasës	Mbajtja e maskës mbrojtëse është e detyrueshme për të gjithë nxënësit dhe mësuesit jashtë klasës	Maska mbrojtëse është e detyrueshme për (çdo) qëndrim në shkollë
Aktivitetet në natyrë nëse është e mundur	Nëse nuk mund të ruhet distanca prej 1 metri gjatë aktiviteteve në grup, mësuesi mund të urdhërojë mbajtjen e maskave mbrojtëse	Nëse nuk mund të ruhet distanca prej 1 metri gjatë aktiviteteve në grup, mësuesi mund të urdhërojë mbajtjen e maskave mbrojtëse	Puna me radhë në ambientin e shkollës duke formuar grupe të vogla

¹ Shkollat e arsimit të mesëm të ulët, shkollat e mesme të përgjithshme, shkollat profesionale dhe institutet e arsimit të veçantë

² I gjelbër: Rrezik i ulët, vetëm raste të veçuara; I verdhë: Rrezik i mesëm; Portokalli: Rrezik i lartë, pasi numri i infeksioneve të reja është në rritje; I kuq: rrezik shumë i lartë, përhapje e pakontrolluar

	Mbajtja e maskave mbrojtëse është e detyrueshme për personat jo të shkollës (p.sh. nëpër projekte)	Nuk ka aktivitete shkollore, kompeticione sportive apo ekskursionet të shkollës + Nuk ka pjesëmarrje të personave jo të shkollës (p.sh. nëpër projekte)	Ngritja e qendrave mësimore për nxënës, me nevoja për financim të mëtejshëm ose pa kompjuter/laptop
Lejohen ushtrime dhe sportet (në klasë dhe gjatë pushimit), preferohet të kryhen përjashta	Sportet kryesisht përjashta, në palestra vetëm me kushte të posaçme dhe duke ruajtur distancën prej 2 metrash	Sportet vetëm përjashta dhe vetëm nëse mund të ruhet distanca prej 2 metrash	Sportet si pjesë e Distance Learning (mësimi në distancë); Në shkollë vetëm nëse mund të ruhet distanca prej 2 metrash
Lejohet këndimi në orën e muzikës (ose të korit), nëse është e mundur duhet të ruhet distancë prej 1,5 metrash	Këndimi në orën e muzikës (ose të korit) Vetëm përjashta, në ambiente të mbyllura vetëm me maska mbrojtëse	Ndalohet këndimi në ambiente mbyllura	
Zhvillohet normalisht kujdesi i pasdrekës	Zhvillohet kujdesi i pasdrekës - është e detyrueshme mbajtja e maskës mbrojtëse për të gjithë jashtë klasës/grupit	Nuk lejohet kombinim i rupeve, nuk lejohet ndryshimi i ambientit	Kujdesi gjatë gjithë ditës në modalitet emergjence; Duhet formuar grupe të vogla kur ndodheni në shkollë
	Dreka në shkollë zhvillohet me turne në varësi të hapësirës së mundshme		Kontakti personal mes nxënësve dhe kujdestarëve duhet të minimizohet sa më shumë të jetë e mundur, p.sh. përkujdesje me ndihmën e kompjuterit

Informacion i mëtejshëm për semaforin e koronavirusit dhe masat për COVID-19 për shkollat mund të gjenden në faqen e internetit të Ministrisë Federale të Arsimit, Shkencës dhe Kërkimit: <https://www.bmbwf.gv.at/Themen/schule/beratung/corona/coronaampel.html>